REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

MARS 2024

# EKONOMIA DHE BUXHETI

## Raport Mujor

# EKONOMIA DHE BUXHETI

## Raport Mujor

## Mars 2024

© Ministria e Financave, 2024
Drejtoria e Përgjithshme e  Programimit Makroekonomik dhe Fiskal
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë

www.financa.gov.al

**E-mail: Dajana.Metolli@financa.gov.al**

# Përmbajtja

**VEÇORITË KRYESORE** ______ **2**

**ZHVILLIMET EKONOMIKE** ______ **3**

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit ______ 3
2. Kursi mesatar i Këmbimit ______ 4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave ______ 5
4. Bilanci i Pagesave ______ 6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar______ 7
6. Kredia për Ekonominë ______ 8
7. Oferta e Parasë ______ 9
8. Depozitat sipas burimeve______ 10

**SEKTORI FISKAL** ______ **11**

1. Buxheti i Konsoliduar ______ 11
2. Të Ardhurat Sipas Burimeve ______ 12
3. Financimi i Bilancit Fiskal ______ 13

**ANEKSI STATISTIKOR** ______ **13**

# Veçoritë Kryesore

- Indeksi i çmimeve të konsumit në muajin mars 2024, arriti në 116.81;
- Norma vjetore e inflacionit për muajin mars 2024 ishte 2.3 përqind;
- Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin mars 2024 ishte 95.32 lekë për dollarë dhe 103.57 lekë për euro;
- Normat mesatare të interesit të depozitave në lekë sipas individëve dhe korporatave jo-financiare gjatë muajit mars 2024 shënuan kuotën 1.83 dhe 2.29 përqind;
- Normat mesatare të interesit të huave në lekë sipas Individëve dhe korporatave jo-financiare gjatë muajit mars 2024 shënuan përkatësisht vlerat 6.67 dhe 6.39 përqind;
- Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,690,533 milionë lekë në muajin mars 2024, duke shënuar një rritje prej rreth 2.4 përqind krahasuar me një vit më parë;
- Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e katërt të 2023 rezultoi me rënien e mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën 232.2 milionë euro;
- Situata Buxhetore për periudhën mars 2024 rezultoi me një suficit të përgjithshëm prej rreth 32.34 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një suficit prej 26.37 miliardë lekë;
- Të ardhurat gjithsej të realizuara për mars 2024, arritën në rreth 164.27 miliardë lekë ose afërsisht 5.2 përqind më shumë se muaji mars 2023 dhe 101.3 përqind realizim kundrejt planit të periudhës;
- Shpenzimet gjithsej gjatë së njëjtës periudhë, arritën në rreth 131.93 miliardë lekë ose rreth 5.3 përqind më shumë se muaji mars 2023 dhe 97.1 përqind realizim kundrejt planit të periudhës;

# Zhvillimet Ekonomike

## 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin mars 2024 shënoi 2.3%, duke reflektuar një rënie në krahasim me një vit më parë ku ky ndryshim shënoi 5.3%. Ndryshimi mujor i Indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK), në muajin mars 2024 krahasuar me shkurt 2024 ka shënuar rritje me 0.4%. Referuar një viti më parë IÇK për muajin mars 2023 shënoi rritje mujore prej 0.7 % në krahasim me muajin paraardhës.

Fig. 1




*Ndryshimet mujore/vjetore të IÇK-së*

Burimi: INSTAT

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, grupet të cilat patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin:

- "Ushqime dhe pije joalkolike" me rritje vjetore të çmimit prej +2.0%, duke kontribuar me +0.70 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.3%.
- "Qera, ujë, lëndë djegëse dhe energji" me rritje vjetore të çmimit prej +2.4%, duke kontribuar me +0.45 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.3%.
- "Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje", me rritje vjetore +4.2%, duke kontribuar me +0.31 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.3%.
- "Mallra dhe shërbime të ndryshme" me rritje vjetore të çmimit prej +3.3%, duke kontribuar me +0.18 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.3%.
- "Pije alkoolike dhe duhan" me rritje vjetore të çmimit prej +3.3%, duke kontribuar me +0.16 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.3%.
- "Hotele, kafene dhe restorante" me rritje vjetore të çmimit prej +3.5%, duke kontribuar me +0.16 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.3%.

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)

| VITI | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2023 | 7.2 | 7.1 | 5.3 | 4.6 | 4.7 | 4.5 | 4.2 | 4.0 | 4.1 | 3.8 | 3.9 | 4.0 |
| 2024 | 3.4 | 2.6 | 2.3 | | | | | | | | | |

*Burimi: INSTAT*

## 2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin mars 2024, arriti në 103.57 lekë/euro, duke u rritur me 0.33 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit mars një euro u këmbye me 102.87 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin mars 2024 arriti në 95.32 lekë/dollarë duke shënuar rritje në vlerë me 1.01 përqind kundrejt një muaji më parë. Në fund të muajit mars, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 95.37 lekë/dollarë.

Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, shënoi një nivel mesatar rreth 0.92 dollarë/euro për muajin mars 2024.

Në krahasim me muajin mars të vitit të kaluar, pas një periudhe të konsiderueshme forcimi, rezulton se monedha shqiptare ka pësuar një mbiçmim ndaj monedhës europiane në masën 9.43 përqind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është mbiçmuar në masën 10.84 përqind. Forcimi i monedhës vendase ndaj euros këtë vit ka ndihmuar në zbutjen e pjesshme të presioneve inflacioniste nga jashtë.

Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, forcimi i lekut mund të shpjegohet me përmirësimet në bilancin e llogarisë korrente, rritjen e invesimeve të huaja direkte, por edhe me efektet e normalizimit monetar dhe rritjes së normave të interesit si dhe si rezultat i stabilitetit të situatës makroekonomike në vend.

Fig. 2




Ecuria e kursit të këmbimit Mars 2024
Burimi: Banka e Shqipërisë

## 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit mars 2024, normat mesatare të interesit të depozitave me afat në lekë sipas Individëve dhe Korporatat jo-financiare shënuan përkatësisht vlerat prej 1.83 dhe 2.29 përqind. Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të depozitave sipas individëve kanë shënuar rënie me 0.05 pikë përqindje dhe Korporatat jo-financiare kanë shënuar rritje me 0.09 pikë përqindje. Ndërsa krahasuar me një vit më parë kanë shënuar rritje me 0.37 pikë përqindje për Individët dhe një rritje me 0.46 pikë përqindje për Korporatat jo-financiare.

Fig. 3




*Normat e interesit për depozitat sipas individëve, KJF dhe BTH-12M (në %)*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Normat e interesit të bonove të thesarit 12 mujore për muajin mars 2024 kanë shënuar kuotën 3.63 përqind, nga 3.94 përqind që shënonte për të njëjtën periudhë një vit më parë. Bonoja 12-mujore shënoi rritje me 0.01 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë dhe rënie vjetore me 0.31 pikë përqindje.

Gjatë muajit mars 2024 normat mesatare të interesit të huave sipas Individëve dhe korporatave jo-financiare shënuan përkatësisht vlerat 6.67 dhe 6.39 përqind. Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të huave sipas individëve u ulën me 0.22 pikë përqindje ndërsa normat e interesit sipas korporatave jo-financiare u ulën me 0.45 pikë përqindje. Ndërsa krahasuar me një vit më parë kanë shënuar rënie me 0.94 pikë përqindje për Individët dhe janë ulur me 1.23 pikë përqindje për Korporatat jo-financiare.

Fig. 4




Normat e interesit për huatë sipas individëve (në %)

Burimi: Banka e Shqipërisë

# 4. Bilanci i Pagesave

Përgjatë vitit 2023, Bilanci i Pagesave rezultoi pozitiv, me rritje të mjeteve të rezervës valutore, duke shënuar vlerën 937 milion euro, nga -70 milion euro që ishte një vit më parë (2022). Gjithashtu, vetëm për tremujorin e katërt të 2023, BP shënoi vlerën 151 milion euro, krahasuar me tremujorin e katërt të 2022 që shënoi vlerën rreth -12 milion euro. Përgjatë vitit 2023, defiçiti i llogarisë korente pati një ngushtim në vlerën -190 milionë euro krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë që ishte -1,063 miliardë euro. Po ashtu, vetëm për tremujorin e katërt të 2023, llogaria korente e ngushtoi deficitin në -232 milion euro, krahasuar me tremujorin e katërt të 2022 që ishte -473 milion euro.

Fig. 5




Bilanci i Pagesave T4 - 2023

Burimi: Banka e Shqipërisë

Përgjatë vitit 2023, Llogaria financiare dhe kapitale u zgjerua në vlerën +1,063 milionë euro krahasuar me +840 milionë euro në vitin 2022. Gjithashtu, vetëm për tremujorin e katërt të 2023, llogaria financiare dhe kapitale u zgjerua në +320 milionë euro krahasuar me +310 milionë euro në tremujorin e katërt të 2022. Përgjatë vitit 2023, Investimet e huaja direkte shënuan vlerën +1,492 miliardë euro ose +8.7% krahasuar me +1,372 miliardë euro në vitin 2022. Gjithashtu, vetëm për tremujorin e katërt të 2023, IHD u zgjeruan në vlerën +402 mln euro ose +3.5%, krahasuar me +388 mln euro në tremujorin e katërt të 2022.

Fig. 6




Llogaria Korente T4 - 2023

Burimi: Banka e Shqipërisë

# 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit mars 2024, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 74,058 milionë lekë krahasuar me muajin mars 2023. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto në Bankat Paradepozituese me 62,937 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë mjetet valutore neto kanë shënuar rënie me 2,654 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rënia mujore prej 2,734 milionë lekë në Bankën Qëndrore.

Fig. 7




Ecuria e M.V.N. të sistemit Mars'24 -Mars'23

Burimi: Banka e Shqipërisë

Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,690,532.90 milionë lekë në muajin mars 2024 duke shënuar një rritje prej rreth 38,854.5 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 2.4 përqind.

Në muajin mars, sistemi bankar rezulton me rënie mujore prej 12,519.5 milionë lekë.

Fig. 8




Agregati M3 Mars'24-Mars'23

Burimi: Banka e Shqipërisë

# 6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin mars 2024 arriti në rreth 763,204 milionë lekë. Bilanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje në vlerë me 52,142.8 milonë lekë, ose rritje me rreth 7.33 përqind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (57.9%) dhe monedhave të huaja (42.1%).

Fig. 9




***Rritja e stokut total të kredive Mars'24***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjatë muajit mars 2024, zëri "Korporata të tjera jo-financiare", zuri peshën më të lartë të totalit të kredive, me rreth 56.1 përqind ose 427,858 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 38.7 përqind ose rreth 295,437 milionë lekë. Zërat "Korporata jo financiare publike" dhe "Korporata të tjera financiare" arritën respektivisht 2.4 dhe 2.8 përqind apo 18,462 dhe 21,369 milionë lekë.

Fig. 10




***Përberja e kredive Mars'24***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës së huaj për muajin mars 2024 zëri "Koorporata të tjera jofinanciare" zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 69.15 përqind, ndjekur nga "Sektorë të tjerë rezidentë" me rreth 25.42 përqind. "Koorporata të tjera financiar" dhe "Koorporata jofinanciare publike" kontribuojnë përkatësisht me 2.46 dhe 2.96 përqind secili.

# 7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 389.975 milionë lekë në fund të muajit mars 2024. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në mars 2024 ka shënuar një rritje mujore prej 0.29 përqind dhe rënie vjetore prej 0.11 përqind, duke arritur nivelin 23.1 përqind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar rritje mujore prej 0.09 përqind, dhe rënie vjetore prej 0.18 përqind, duke shënuar nivelin 30. përqind.

Fig. 11




*Raporte të parasë jashtë bankave me M3 & Depozitat Mars'24*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin mars 2024, kanë shënuar rënie vjetore prej 6,907 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 74.1 përqind të depozitave në valutë. Gjithashtu depozitat në Lekë gjatë muajit mars 2024 shënuan rritje prej 38,539 milionë lekë në krahasim me muajin mars 2023. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 75.1 përqind të depozitave në lekë

Fig. 12




Raporti i Depozitave ndaj M3 Mars'24

Burimi: Banka e Shqipërisë

# 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit mars 2024, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 75.1 përqind, ndjekur nga “Koorporata të tjera jofinanciare”, me rreth 19.1 përqind dhe nga “Koorporata jo-financiare publike” me 3.4 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Koorporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 741 përqind dhe rreth 23.3 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 74.5 përqind e totalit.

Fig. 13




Rritja e stokut total të depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 969.554 milionë lekë të depozitave totale. Ato ndiqen nga “Koorporata të tjera jofinanciare” (278.158 milionë lekë), “Koorporata të tjera financiare” (24.381 milionë lekë), dhe “Koorporata jofinanciare publike” (26.129 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth (2.335 milionë lekë) në totalin e depozitave. Gjatë muajit mars 2024, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 1,300,557 milionë lekë.

Fig. 14




Përberja e depozitave Mars'24

Burimi: Banka e Shqipërisë

Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave shënoi rënie prej rreth 14,599 milionë lekë. Ndërsa, krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rritje me 31,633 milionë lekë

# Sektori Fiskal

## 1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën mars 2024 janë mbledhur rreth 164.275 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 131.933 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 125.649 miliardë lekë shpenzimet korrente dhe rreth 35.490 miliardë lekë shpenzimet për fonde speciale.

Fig. 15




*Treguesit Fiskal,Mars'24*

Burimi: Ministria e Financave

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 111.763 miliardë lekë (0.5% më shumë se plani i periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor janë rreth 7.063 miliardë lekë (22.8%% më shumë se plani i periudhës). Të ardhurat nga fondet speciale janë rreth 39.204 miliardë lekë (ose rreth 1.9% më shumë se plani i periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 5.397 miliardë lekë (ose rreth 8.5% më pak se plani i periudhës).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 125.649 miliardë lekë, 25.749 miliardë lekë (20.49% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 16.619 miliardë lekë (13.22% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime interesi, 9.829 miliardë lekë (7.82% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 210 milionë lekë (0.16% e totalit të shpenzimeve korrente) për subvencione, 53.490 miliardë lekë (42.57%) për shpenzime për fonde speciale, 13.418 miliardë lekë (10.67% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzimet e qeverisjes vendore, dhe 6.335 miliardë lekë (5.04% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime të tjera.

## 2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën mars 2024 ishin rreth 164.275 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 158.030 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 5.397 miliardë lekë.

**Tab - 2** Të ardhurat tatimore gjatë muajit Mars 2024 (mln Lekë)

| Emërtimi | Mars'24 | Mars'23 | Mars'24/Mars'23 Rritja në (%) |
|---|---|---|---|
| Tatimi mbi Vleren e Shtuar | 51,794 | 45,902 | 12.8 |
| Tatimi mbi Fitimin | 18,651 | 21,608 | -13.7 |
| Akcizat | 13,054 | 12,056 | 8.3 |
| Tatimi mbi të Ardhurat Personale | 15,288 | 13,236 | 15.5 |
| Taksa Nacionale dhe të tjera | 10,988 | 9,895 | 11.1 |
| Taksa Doganore | 1,987 | 1,977 | 0.5 |

*Burimi:* Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Mars 2024

## 3. Financimi i Bilancit Fiskal

Suficiti prej 32.34 miliardë lekë për periudhën mars 2024 u financua kryesisht nga huamarrja afatgjatë e brendshme si mjeti kryesor i financimit dhe huamarrja e huaj.

Për periudhën mars 2024, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 164.275 miliardë lekë,
- Realizimi i shpenzimeve në masën 131.933 miliardëlekë.

Në realizimin e të ardhurave progresive për periudhën mars 2024, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat tatimore, të cilat arrijnë shifrën e 158.030 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 125.649 miliardë lekë dhe shpenzimet për fonde speciale me rreth 53.490 miliardë lekë.

# Aneksi Statistikor

Tab - 1

| Muaji | Mujor (Monthly) | | | | | Mesatar Mujor (Monthly | | | | | Vjetor (Annual) | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | Month |
| Janar | 1.9 | 1.3 | 1.3 | 1.1 | 0.5 | 1.9 | 1.3 | 1.3 | 1.1 | 0.5 | 1.5 | 0.4 | 3.7 | 7.2 | 3.4 | January |
| Shkurt | 0.4 | 1.1 | 1.3 | 1.1 | 0.3 | 1.1 | 1.2 | 1.3 | 1.1 | 0.4 | 1.2 | 1.1 | 3.9 | 7.1 | 2.6 | February |
| **Mars** | 0.6 | 0.7 | 2.4 | 0.7 | **0.4** | 0.9 | 1.0 | 1.7 | 1.0 | **0.4** | 2.1 | 1.2 | 5.7 | 5.3 | **2.3** | **March** |
| Prill | -0.4 | 0.2 | 0.7 | 0.03 | | 0.6 | 0.8 | 1.4 | 0.9 | | 1.9 | 1.9 | 6.2 | 4.6 | | April |
| Maj | -0.8 | -0.9 | -0.5 | -0.3 | | 0.3 | 0.5 | 1.0 | 0.7 | | 2.1 | 1.8 | 6.7 | 4.7 | | May |
| Qershor | -0.6 | -0.8 | -0.1 | -0.3 | | 0.2 | 0.3 | 0.9 | 0.6 | | 1.8 | 1.6 | 7.4 | 4.5 | | June |
| Korrik | -0.5 | 0.1 | 0.2 | -0.1 | | 0.1 | 0.2 | 0.8 | 0.5 | | 1.4 | 2.2 | 7.5 | 4.2 | | July |
| Gusht | 0.2 | 0.4 | 0.8 | 0.6 | | 0.1 | 0.3 | 0.8 | 0.5 | | 1.3 | 2.4 | 8.0 | 4.0 | | August |
| Shtator | 0.4 | 0.5 | 0.6 | 0.7 | | 0.1 | 0.3 | 0.7 | 0.4 | | 1.5 | 2.5 | 8.1 | 4.1 | | September |
| Tetor | 0.2 | 0.1 | 0.4 | 0.1 | | 0.1 | 0.3 | 0.7 | 0.4 | | 2.0 | 2.4 | 8.3 | 3.8 | | October |
| Nëntor | -0.5 | 0.2 | -0.3 | -0.2 | | 0.1 | 0.3 | 0.6 | 0.3 | | 1.6 | 3.1 | 7.9 | 3.9 | | November |
| Dhjetor | 0.3 | 0.8 | 0.4 | 0.5 | | 0.1 | 0.3 | 0.6 | 0.3 | | 1.1 | 3.7 | 7.4 | 4.0 | | December |

***Burimi*** *: INSTAT* ***Source*** *: INSTAT*

Tab - 2 **Kursi i këmbimit**

*Exchange rate*

| Monedha | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 Janar January | 2024 Shkurt February | 2024 Mars March | Currency |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Mesatarja e periudhës* | | | | | | | | *Average of period* |
| USD | 108.65 | 103.68 | 113.04 | 100.65 | 95.33 | 96.29 | **95.32** | USD |
| EURO | 123.77 | 122.37 | 118.98 | 108.80 | 103.91 | 103.91 | **103.57** | EURO |
| *Fundi i periudhës* | | | | | | | | *In the end of period* |
| USD | 100.84 | 106.54 | 107.05 | 93.94 | 95.95 | 95.92 | **95.37** | USD |
| EURO | 123.70 | 120.76 | 114.23 | 103.88 | 103.90 | 103.99 | **102.87** | EURO |

**Burimi** : *Banka e Shqipërisë* **Source** : *Bank of Albania*

Tab - 3 **Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)**

*Annual Interest Rates (in ALL)*

| Në përqindje | 2024 Janar January | 2024 Shkurt February | 2024 Mars March | In percent |
|---|---|---|---|---|
| *Norma e interesit të depozitave për individë* | | | | *Interest rates on households deposits* |
| Deri në 1 vit | 1.07 | 1.69 | 1.53 | Up to 1 year |
| Nga 1-2 vite | 1.77 | 1.73 | 2.33 | From 1 to 2 years |
| Mbi 2 vjet | 2.93 | 2.45 | 2.54 | Over 2 years |
| Norma e interesit të depozitave për korporatat jo-financiare | | | | *Interest rates on nonfinancial corporations deposits* |
| Deri në 1 vit | 3.01 | 1.99 | 2.11 | Up to 1 year |
| Nga 1-2 vite | 2.49 | 2.88 | 3.17 | From 1 to 2 years |
| Mbi 2 vjet | 4.69 | 4.50 | 4.54 | Over 2 years |
| *Normat e interesit të kredive per individet* | | | | *Interest rates on household loans* |
| Kredi për banesa | 4.35 | 4.75 | 4.29 | Lending for house purchase |
| Kredi konsumatore | 9.89 | 9.75 | 9.34 | Consumer credit |
| Kredi për qëllime të tjera | 10.46 | 11.08 | 12.36 | Credit for other purposes |
| *Normat e interesit të kredive per korporatat jofinanciare* | | | | *Interest rates on nonfinancial corporations loans* |
| Kredi deri në 140 milion lekë | 6.86 | 6.77 | 7.06 | Loans up to to an amount of 140 millions of lek |
| Kredi mbi 140 milionë lekë | 7.35 | 7.01 | 5.85 | Loans over an amount of 140 millions of lek |
| *Norma e letrave me vlerë* | | | | *Securities rates* |
| Bono thesari 1/ | | | | Treasury bills 1/ |
| 3-M | 3.09 | - | - | 3-M |
| 6-M | - | 3.28 | - | 6-M |
| 12-M | 3.48 | 3.62 | 3.63 | 12-M |

***Burimi :*** *Banka e Shqipërisë* — ***Source*** *: Bank of Albania*

Tab - 4 **TREGUESIT FISKAL SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2024**

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2024

*Të dhëna progresive (Progresive Data)* *në milionë Lekë (in million ALL)*

| Nr. | E M Ë R T I M I | January Janar | February Shkurt | March Mars | ITEMS |
|---|---|---|---|---|---|
| | **TOTALI TË ARDHURAVE** | **54,516** | **104,291** | **164,275** | **TOTAL REVENUE** |
| **I.** | **Të ardhura nga ndihmat** | **170** | **354** | **848** | **Grands** |
| **II.** | **Të ardhura tatimore** | **52,589** | **100,122** | **158,030** | **Tax Revenue** |
| **II.1** | **Nga Tatimet dhe Doganat** | **36,346** | **69,613** | **111,763** | **From tax offices and customs** |
| 1 | Tatimi mbi Vlerën e Shtuar | 18,310 | 35,469 | 51,794 | V.A. T |
| 2 | Tatimi mbi Fitimin | 2,859 | 5,959 | 18,651 | Profit Tax |
| 3 | Akcizat | 4,299 | 8,553 | 13,054 | Excise Tax |
| 4 | Tatimi mbi të Ardhurat Personale | 5,710 | 10,484 | 15,288 | Personal Income Tax |
| 5 | Taksa Nacionale dhe të tjera | 4,528 | 7,858 | 10,988 | National Taxes and others |
| 6 | Taksa Doganore | 639 | 1,290 | 1,987 | Customs Duties |
| **II.2** | **Të ardhura nga Pushteti Vendor** | **1,447** | **3,597** | **7,063** | **Revenues from Local Gov.** |
| 1 | Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat) | 257 | 551 | 1,253 | Property Tax |
| 2 | Taksë mbi Biznesin e vogël | 7 | 12 | 18 | Small Business Tax |
| 3 | Taksa Lokale | 1,182 | 3,034 | 5,792 | Local Taxes |
| **II.3** | **Të ardh nga fondet speciale** | **14,797** | **26,912** | **39,204** | **Social ins. contributions** |
| 1 | Sigurimi Shoqeror | 12,748 | 23,287 | 33,981 | Social Insurance |
| 2 | Sigurimi Shëndetsor | 2,013 | 3,576 | 5,150 | Health insurance |
| 3 | Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve | 35 | 50 | 73 | Compensation income in the value of owners |
| **III.** | **Të ardhura Jotatimore** | **1,758** | **3,814** | **5,397** | **Nontax Revenue** |
| 1 | Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë | 0 | 0 | | Profit transfer from BOA |
| 2 | Të ardhura nga Inst.Buxhetore | 1,023 | 2,347 | 3,209 | Income of budgetary institutions |
| 3 | Tarifat shërbimeve | 246 | 477 | 660 | Utility fees |
| 4 | Të tjera | 489 | 990 | 1,529 | Others |
| | **TOTALI I SHPENZIMEVE** | **39,090** | **83,719** | **131,933** | **TOTAL EXPENDITURE** |
| **I.** | **Shpenzime Korrente** | **38,576** | **82,488** | **125,649** | **Current Expenditures** |
| **I.1** | **Personeli** | **8,461** | **17,145** | **25,749** | **Personnel expenditures** |
| 1 | Paga | 7,264 | 14,718 | 22,082 | Wages |
| 2 | Kontributi për Sigurime Shoqerore | 1,183 | 2,375 | 3,558 | Social insurance contributions |
| 3 | Arsimi I larte nga te ardhurat e veta | 13 | 53 | 108 | Higher education from its own income |
| **I.2** | **Interesat** | **6,870** | **11,884** | **16,619** | **Interest** |
| 1 | Të Brendshme | 5,767 | 10,105 | 13,395 | Domestic |
| 2 | Të Huaja | 1,103 | 1,778 | 3,224 | Foreign |
| **I.3** | **Shpenzime Operative Mirëmbajtje** | **1,784** | **6,067** | **9,829** | **Operational & Maintenance** |
| **I.4** | **Subvecionet** | **39** | **93** | **210** | **Subsidies** |
| **I.5** | **Shpenzime për fonde speciale** | **16,709** | **35,365** | **53,490** | **Social insurance outlays** |
| 1 | Sigurime Shoqerore | 13,306 | 26,617 | 40,673 | Social insurance |
| 2 | Sigurime Shëndetsore | 3,403 | 8,514 | 12,475 | Health insurance |
| 3 | Fondi I kompensimit të pronarëve | 0 | 234 | 342 | Owners' Compensation Fund |
| **I.6** | **Shpenzime per Buxhetin Vendor** | **3,040** | **7,953** | **13,418** | **Local budget expenditure** |
| **I.7** | **Shpenzime të tjera** | **1,674** | **3,981** | **6,335** | **Other expenditures** |
| 1 | Pagesa e Papunesisë | 61 | 134 | 204 | Unemployment insurance benefits |
| 2 | Ndihma Ekonomike | 1,513 | 3,507 | 5,504 | Economic Aid |
| 3 | Bonusi I lindjeve | 100 | 300 | 500 | Birth bonus |
| **I.8** | **Transferime Kapitale** | **0** | **0** | **0** | **Capital transfers** |
| **II** | **Fondi Rezerve, Kontigjenca** | **0** | **0** | **0** | **Reserve fund/contigency** |
| **III** | **Shpenzime Kapitale** | **514** | **1,080** | **6,284** | **Capital expenditures** |
| 1 | Financimi Brendshëm | 0 | 95 | 2,655 | Domestically financing |
| 2 | Investime nga te ardhurat e Arsimit te Larte | 0 | 18 | 59 | From higer education system's own revenues |
| 3 | Financimi Huaj | 513 | 968 | 3,262 | Foreign financed |
| **IV** | **Fondi i rindertimit** | **0** | **151** | **308** | **Reconstruction fund** |
| **V.** | **DEFICITI** | **15,426** | **20,571** | **32,342** | **CASH BALANCE** |
| **V.1** | **FINANCIMI DEFICITIT** | **-15,438** | **-20,571** | **-32,342** | **CASH BALANCE FINANCING** |
| **V.2** | **Brendshëm** | **-12,195** | **-14,749** | **-30,523** | **Domestic** |
| 1 | Të ardhura nga privatizimi | 1 | 2 | 2 | Privatization receipts |
| 2 | Hua-marrje e brendshme | -12,000 | -12,745 | -790 | Domestic new borrowing (net) |
| 3 | Të tjera | -196 | -2,006 | -29,735 | Others |
| **V.3** | **I huaj** | **-3,243** | **-5,823** | **-1,819** | **Foreign** |
| 1 | Hua afatgjatë(e marrë) | 348 | 1,211 | 3,377 | Long-term foreign borrowing (gross) |
| 2 | Ndryshimi i gjendjes së arkes* | 8 | -551 | -1,084 | Chang. of stat. Account |
| 3 | Ripagesat | -3,599 | -6,482 | -9,344 | Repayments |
| 4 | Mbështetje Buxhetore | 0 | 0 | 5,232 | Budgetary Support |

***Burimi** : Ministria e Financave* ***Source** : Ministry of Finance*

Tab - 5

**Tabela e investimeve 2024**

*Table of investments 2024*

*Të dhëna progresive (Progresive Data)*

| | Janar<br>January | Shkurt<br>February | Mars<br>March | |
|---|---|---|---|---|
| **Financim i brendshëm** | **-12,195** | **-14,749** | **-30,523** | **Domestic financing** |
| *Në %* | 79.0 | 71.7 | 94.4 | *In %* |
| **Financim i huaj** | **-3,243** | **-5,823** | **-1,819** | **Foreign financing** |
| *Në %* | 21.0 | 28.3 | 5.6 | *In %* |
| **Totali** | -15,438 | -20,571 | -32,342 | **Total** |
